

POLICY BRIEFS

KOSOVO



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

Qershor 2014

[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)

# Roli i Burimeve të Ripërtërithme të Energjisë dhe Eficienca në Zhvillimin Ekonomik të Komunave

**Hamdi Malushaj**

Shoqata për Energji të Ripërtrishme e Kosovës  
(SHERK)

## Parathënie

Sektori i energjisë në Evropës Juglindore është çelës për rritje ekonomike rajonale, rritje prosperiteti dhe njëkohësisht hapës i derës në rrugën për në Bashkimin Evropian, duke marrë parasysh dhe faktin që përmes burimeve natyrore ofrohen mundësi të shumta për investime.

Burimet e energjive të ripërtëritshme janë burime natyrore. Siq e dimë natyra (globi) në bazë të territoreve të sotshme është e ndarë në shtete, të cilat janë të organizuara në komuna. Komuna ka një rol shumë të rëndësishëm në organizimin e shfrytëzimit sa më të mirë dhe pa pasoja në ambient të këtyre burimeve, pra rrjedhimisht gëzon edhe të drejtën në profit komercial të përdorimit të këtyre burimeve. Në këtë rast komunat do të mund të zhvilloheshin ekonomikisht përmes përdorimit të burimeve të enërgjive të ripërtëritshme dhe njëkohësisht arrihet të mbrohet ambienti.

Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme që janë të pashterrshme si resurse të komunës do të mundësonin investime, punësim si dhe të hyra në buxhetin e komunës.

Në vitet e fundit, politikat për promovimin e energjisë së ripërtëritshme janë bërë gjithnjë e më popullore në mesin e komunave, në pjesë të ndryshme të botës. Ky artikull shqyrton rastin e Kosovës. Ajo argumenton se komunat, në krahasim me akterët e tjerë të sektorit publik dhe privatë, duhet të kenë një rol kyç në menaxhimin e burimeve të energjive të ripërtëritshme duke aplikuar modele të ndryshme të sukseshme në bashkimin evropian.

Në vitet e fundit, komuna të shumta në shtete të ndryshme të evropës kanë marrë një rol të theksuar në fushën e energjisë e sidomos në menaxhimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme në territoret e tyre. Madje disa komuna kanë aplikuar pilotprojekte apo ishuj energjetik, plotësisht të pamvarur nga rrjetet nacionale duke u furnizuar krejtësisht përmes energjive të ripërtëritshme. Ata e bëjnë këtë për arsye të ndryshme, të tilla si mbrojtjen e ambientit, forcimin e ekonomisë rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Kosova si vend me një sipërfaqe të vogël gjeografike, ka rezerva të mëdha të qymyrit, mirëpo të gjitha komunat e Kosovës janë të pasura edhe me burime të ripërtëritshme energjetike si Dielli, Era dhe Uji. Këto duhen shfrytëzuar nga vetë komunat të cilat kanë potencial për të luajtur një rol kyç në menaxhimin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

Me rolin e komunës në ekonominë e gjelbërt do të vinin investimet, që do të sillnin profite të konsiderushme për komunitetin, ngritje të kapaciteteve humane, ndërtim të objekteve publike si p.sh. sportive, kulturore, argëtuese etj. dhe kjo në rastin e Kosovës do të sillte edhe nxitjen e investimeve të kapitalit nga diaspora, duke marrë parasysh se në vendet ku jetojnë ata janë të familjarizuar me këtë lloj të zhvillimit ekonomik.

## Draft propozimi i strategjisë së Energjisë 2013 – 2022

Strategjia e Energjisë 2013 – 2022<sup>1</sup> e Republikës së Kosovës si dokument strategjik dhe programor, Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe me Eficiencën e Energjisë (EE) i trajton në një masë shumë të vogël dhe nuk lëshohet në detaje të thella.

Strategjia i përmend në vija të trasha të arrituarat në ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore, nënligjore, rregulative, stimuluese dhe vepruese lidhur me Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe me Eficiencën e Energjisë.

Për sa i përket aspektit të zhvillimit të BRE-ve, Strategjia e Energjisë 2013 - 2022 përmend vetëm vendimet dhe Udhëzimet Administrative të lëshuara nga MZHE-ja si dhe caqet indikative të BRE-ve të cilat janë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011-2022.

Kjo strategji përmend në vija të trasha edhe potencialin energjetik nga energjia e ujit, nga biomasa, nga energjia e erës, nga energjia diellore, nga energjia

---

<sup>1</sup> STRATEGJIA E ENERGJISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2013 – 2022, [http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/SE\\_-\\_Shqip\\_26.12.pdf](http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/SE_-_Shqip_26.12.pdf)

gjeotermale si dhe përmend nevojat e vlerësimit të përdorimit të mbeturinave të shfrytëzueshme.

Me një fjalë kjo strategji nuk bazohet në rolin dhe kërkesat e komunave të cilat do të duhej ta kishin një rol fundamental në përpilimin e saj duke e marrë parasysh faktin që efektet e kësaj strategjie do ti bartin vetë komunat. Një strategji e mirëfillt do të bazohet në konceptin e komunave për energjinë sic ndodh edhe në shtetet e Bashkimit Evropian.

**Eficienca** - është një indikator në zhvillimin ekonomik të komunave. Komunat kanë rol administrativ të gjitha objektet publike që gjenden në territorin e vet, objektet institucionale, shkollat, spitalet, qerdhet, shtepitë korrektuese etj. si dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimet e reja në sektorin publik dhe privat. Duke e rritur konforin e qytetarit dhe kursimin e buxhetit komunal përmes efijencës ndikohet drejtpërdrejtë zhvillimi ekonomik i një komune.

### **Obligimet e Kosovës ndaj Bashkimit Evropian**

Evropa Juglindore dhe në këtë rast edhe Kosova, përmes themelimit të Komunitetit të Energjisë<sup>2</sup> obligohet të përmbushë direktivat evropiane, gjë që i ballafaqon pjesëmarrësit e tregut me sfida të mëdha.

Tema si siguria e furnizimit me energji, zgjerimi i rrjetit, kursimi i energjisë, investimet dhe zhvillimi i projekteve në prodhimin e energjisë konvencionale dhe energjive të ripërtëritshme, si dhe zbatimin e obligimeve të liberalizimit janë vetëm një pjesë e problemeve aktuale në Kosovë. Ndër direktivat të cilat duhet përmbushur Kosova si nënshkruese e traktatit është Direktiva **2004/EG**, **2006/32/EG** dhe direktiva e fundit **2012/27/EU**.<sup>3</sup>

Objektivat mbizotëruese të këtyre direktivave është përmbushja e cakut **20/20/20** që do të thotë:

- **20%** e konsumit total energji e ripërtëritshme
- **20%** efijencë
- **20%** zvogëlim i ndotjes së ambientit/gazrat CO<sub>2</sub>.

Përmes shfrytëzimit të drejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjive dhe mbrojtjes së tyre mund të arrihen këto qëllime:

- zhvillimi ekonomik
- mbrojtja e ambientit
- krijimi i vendeve të reja pune
- decentralizimi i prodhimit të energjisë
- nxitja e konkurrencës në treg
- përshpejtimi i zhvillimit të inovacioneve

Duke pasur parasysh objektivat që dalin nga këto direktiva është e paimagjinueshme që komunat ti realizojnë këto të fundit pa një koncept të mirëfilltë për energjinë e sidomos Kosova e cila ka kaluar në një periudhë paralufte dhe lufte dhe nuk ka pasur një kontinuitet institucional, që të disponoj me të dhëna të domosdoshme si p.sh. metereologjike, statistikore mbi pasuritë e saj etj. që shumica e shteteve i kanë dhe të cilat sado pak do të ju shërbenin atyre për një zhvillim të mëtutjeshëm të kësaj fushe. Pra Kosova duhet të nxiroj me impelmentimin e masave që dalin nga këto direktiva.

Direktiva e fundit e Bashkimit Evropian **2012/27/EU** parasheh rolin e komunave, në efijencë dhe mundësinë e prodhimit decentral të energjisë, e cila direktivë i obligon komunat që të kenë koncepte për energjinë në një afat të caktuar.


<sup>2</sup> Komuniteti i Energjisë, Raport nga Komisioni për Parlamentin dhe Europian dhe Këshillin  
[http://ec.europa.eu/transport/modes/road/news/com\(2014\)-222\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/transport/modes/road/news/com(2014)-222_en.pdf)

<sup>3</sup> Direktiva Evropiane për Energji Efiqiente (2012/27/EU), Udhëzues për implementim të fuqishëm,  
[http://eedguidebook.energycoalition.eu/images/PDF/EE\\_D.pdf](http://eedguidebook.energycoalition.eu/images/PDF/EE_D.pdf)

### Konceptin për energji, eficiencë, ambient dhe klimë<sup>4</sup>

Koncepti komunal për energji, ambient dhe klimë do të ishte si stimulues i zhvillimit të sektorit të energjisë dhe mbrojtjes së ambientit brenda një komune. Do ti përcaktonte konturat e lëvizjeve dhe mbështetjen e akterëve me interes për këtë fushë. Ky koncept do të mundësonte që komunat ta kuptojnë pozitën se ku

- Ulja e shpenzimit të energjisë përmes zbatimit të projekteve për efikasitetin e energjisë (renovim dhe ndërtime të reja të objekteve publike dhe private)
- Shfrytëzim optimal i burimeve të energjive të ripërtëritshme
- Fitim i imazhit, përgaditja për investitor të mundshëm, mundësi e përfitimit nga fondet ekzistuese zhvillimore
- Ambienti i pastër
- Rritja e punësimit, ngritja e kapaciteteve të



gjendjen dhe rrugëtimin nga do të duhej të shkojnë si dhe do të kishte kontroll mbi gjendjen aktuale të sektorit energjetik.

Me fjalë të tjera, koncepti si i tillë është një strategji e cila do të mundësonte hartimin e planeve afat shkurtër, afat mesëm dhe afat gjatë për energji dhe ambient.

Parimet themelore për konceptin do të ishin objektivat, përgjegjësitë, evidentimi dhe menaxhimi i pasurisë së komunave.

#### Koncepti do të sillte keto rezultate:

- Rritja e buxhetit komunal nga tatimet që do të vinin nga projektet


resursëve humane në sektorin privat dhe në administratë komunale

- Optimizimi i zingjirit të vlerave ekzistuese si dhe krijimi i vlerave shtesë me efekt zingjirorë
- Kontrollë mbi gjendjen aktuale të energjisë, efikasitetin dhe ambientit.
- Mbrojtja e qytetarëve nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike
- Të hyra më të mëdha për komunat përmes taksave dhe tatimeve nga operatorët privat të impianteve gjeneruese (erë, diell, biomasë etj.)
- Konkurrencë më e madhe në mes të komunave

Nga ana tjetër duhet të veqohen efektet sekondare në punësim lokal si rrjedhojë e servisimit dhe mirëmbajtjes të impianteve për gjenerim decentral të energjisë duke krijuar uzina lokale, zejtar të rinjë, serviser të rinjë si dhe furnizues me lëndë të parë që do të nxiste zhvillim ekonomik. Konceptin për energji, ambient dhe klimë do ta përpilonin këta akterë që janë të paraqitur më lartë në figurë.

<sup>4</sup> 'Koncepti i energjisë dhe zbatimi i tij i përsheptuar', Ministria Federale Gjermane për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës dhe Siguri Bërthamore, 10.2011, [http://www.bmub.bund.de/fileadmin/bmu-import/files/pdfs/allgemein/application/pdf/konzept\\_top\\_runner\\_en.pdf](http://www.bmub.bund.de/fileadmin/bmu-import/files/pdfs/allgemein/application/pdf/konzept_top_runner_en.pdf)

Në shembullin e Gjermanisë<sup>5</sup> do të paraqesim më poshtë një diagram tregues të rolit të komunave në sektorin energjetik.



Nga Diagrami më lartë mund të shihet kjo se vetëm gjatë vitit 2010 ka pasur të hyra të konsiderueshme në buxhetin komunal nga energjitë e ripërtitshme deri në 10, 5 Miliard Euro.

Më poshtë e paraqesim një shembull praktik të kostove dhe profiteve nga një gjenerator I erës, I cili do të vrente kudo<sup>6</sup>.

1 Gjenerator i erës	
Kapaciteti i instaluar	2,3 MW
fitimet e energjisë elektrike (MWh/a)	4830
zvoglimi i CO2 (t/a)	3680
Flukset financiare	
Kostot e investimit	2.831.875,00 €
Interesi	623.808,00 €
Kostot e instalimit	67.965,00 €
Të ardhurat nga qiraja/per muaj	679,65 €
Të ardhurat nga qiraja	326.232,00 €
Shpenzimet (mirëmbajtjen / punëtorët / sigurimi)	1.544.201,00 €
Taksa e biznesit (Shkalla e vlerësimit)	403.899,00 €
Fitimi pas tatimit	2.893.233,00 €
Kompania vendore që operon + tokë e komunës	
Vlera e shtuar për komunat	3.623.363,00 €
Vlera e shtuar për regjion	5.859.337,00 €
Kompania e jashtme që operon + tokë private	
Vlera e shtuar për komunat	282.729,00 €
Vlera e shtuar për regjion	608.961,00 €

Tabela 1: Paraqitja e një shembulli praktik të kostove dhe profiteve nga një gjenerator I erës

## Energjia nga biomasa si zhvillim ekonomik i një Komune

Në territorin e Kosovës pa dallim të gjitha komunat disponojnë me mundësi të prodhimit të energjisë nga biomasa. Mirëmbajtja e ambientit paraqet një burim të mirë dhe pothuajse të mjaftueshem për prodhimin e energjisë termike, për nevojat e komuniteteve. Mund të themi se biomasa edhe sot është burimi kryesor për prodhimin e energjisë termike, mirëpo i keqpërdorur dhe i keqtrajtuar duke ndrikuar kështu edhe në shkatërrimin e ambientit që ndikon në ambient dhe klimë.

Siq e dijmë, edhe energjia nga biomasa hynë në energjitë e ripërtitshme e cila trajtohet me tarifë nxitëse. Vetë rregullorët që do të rrjedheshin nga një koncept komunal do ta ndihmonin komunitetin e biznesit për gjenerimin e energjisë nga biomasa.

## Por si do të mund të përdorej biomasa për zhvillim ekonomik?

- Nxitja e punësimit në kompanitë e prodhimit të biomasës nga
  - mbetjet drusore nepër pyje dhe në ambientin që na rrethon
  - mbetjet nga përpunuesit e industrisë së drurit
  - bujqësia (kashta, kitja e hardhisë së rrrushit etj.)
  - mbeturinat e djegshme
  - mbetjet e rrjeteve të kanalizimit pas procesit të filtërimit
  - biogasi (metan) i fermave të blegtorisë
  - biodisel nga kultivimi i kulturave bujqësore
- Nxitja e punësimit eventual në prodhimin dhe montimin e pajisjeve eficiente për djegjen e biomasës
- Punësimi dhe gjenerimi i të ardhurave nga kompanitë të cilat do ti organizonin centralet dhe rrjetin për shfrytëzimin e energjisë termike nga konsumatori fundor.
- Punësimi nga grumbullimi, sortimi dhe reciklimi i mbeturinave

<sup>5</sup> The Institute for Applied Material Flow Management (IfaS), <http://www.stoffstrom.org/en/>

<sup>6</sup> Introduction of the Institute for applied Material Flow Management, Dr. Michael Knaus, 2013  
<http://www.energy.gov.lk/pdf/me/Introduction%20about%20IfaS%20%20By%20Dr%20Michael.pdf>

## Vështrim mbi burime të energjisë së ripërtëritshme dhe zhvillimi i tyre

Si burime të ripërtëritshme të energjisë, konsiderohen të gjitha ato burime që në natyrë shfaqen në forma të ndryshme dhe janë të pashtershme, do të thotë rigjenerohen vazhdimisht.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë janë duke përjetuar një periudhë të hovshme të zhvillimit të tyre në nivel botëror dhe janë duke kontribuar dukshëm në rritjen e prodhimit të energjisë.

Këto burime përveç që janë të pashtershme po ashtu nuk kanë asnjë ndikim negativ në mjedis pasi ato nuk lirojnë gazra e as mbetje ndotëse të rrezikshme për jetën e njeriut dhe të kafshëve.

Energjia elektrike e cila përfitohet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë quhet ndryshe edhe energji e gjjelbër apo energji ekologjikisht e pastërt.

Si burime të ripërtëritshme të energjisë, veçohen:

- energjia e erës,
- energjia diellore,
- hidroenergjia,
- energjia e biomasës,
- energjia gjeotermike,
- energjia e valëve të detit,
- energjia baticës dhe zbatës,
- gazi nga mbeturinat.

Varësisht nga teknologjitë që përdoren, të gjitha burimet e lartpërmendura mund të përdoren për ngrohje, për ftohje, për gjenerim të energjisë elektrike, për gjenerim të biogazit etj.

Burimet e ripërtëritshme janë vazhdimisht duke luajtur një rol kyç në përdorimin dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

## Perspektiva e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë

Aktualisht, në mbarë botën është duke ndodhur një zhvillim enorm i energjive të ripërtëritshme. Krahas energjisë së ujit dhe asaj të biomasës të cilat deri më

tani në masë të madhe janë përdorur për gjenerim të energjisë elektrike dhe për ngrohje, në mënyrë drastike kanë filluar të zhvillohen edhe sektorët e energjisë së erës, energjisë solare, gjeotermike etj.

Disa prej shteteve të zhvilluara industriale, një pjesë të konsiderueshme të furnizimit të tyre me energji elektrike e mbulojnë pikërisht nëpërmjet diversifikimit të burimeve respektivisht nëpërmjet përdorimit të energjive të ripërtëritshme nga uji, biomasa, dielli, era, gjeotermia etj.

Sipas raportit mbi Statusin Global për Energjitë e Ripërtëritshme 2013<sup>7</sup>, energjitë e ripërtëritshme në vitin 2011 dhe 2012 kanë sjellë rreth 19 % të energjisë në konsumin final respektivisht kanë kontribuar me 26 % në furnizimin me energji.

Edhe në kontinentin tonë trendi zhvillimor i energjive të ripërtëritshme është në rritje e sipër. Sipas Eurostat<sup>8</sup>, pjesëmarrja e energjive të ripërtëritshme në konsumin e përgjithshëm final në shtetet e BE-së në vitin 2011 (13%) është ngritur për gati 1 % krahasuar me atë në vitin 2010 e cila ishte vetëm 12.1 %.

Shtetet e BE-së të cilat në vitin 2011 arritën përqindjen më të lartë të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme vijnë në këtë renditje:

- Suedia me 46.8 %,
- Lituania me 33.1 %,

Bashkimi Evropian ka për qëllim, që energjitë e ripërtëritshme ti zhvilloj edhe mëtej dhe përkritazi me këtë ka miratuar legjislacionin përkatës respektivisht të ashtuquajturat Acquis<sup>9</sup> për burimet e ripërtëritshme i cili përfshin direktivat e ndryshme si: Di-

<sup>7</sup>Burimet e Ripërtëritshme, Raport global për gjendjen, 2013, [http://www.ren21.net/portals/0/documents/resources/qsr/2013/qsr2013\\_lowres.pdf](http://www.ren21.net/portals/0/documents/resources/qsr/2013/qsr2013_lowres.pdf)

<sup>8</sup>Eurostat është zyra statistikore e Bashkimit Evropian e vendosur në Luksemburg. Detyra e saj është të sigurojë Bashkimin Evropian me statistikat në nivel evropian që mundësojnë krahasime midis vendeve dhe regjioneve.

<sup>9</sup>ENERGY COMMUNITY ACQUIS, [http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/EU\\_Legislation](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/EU_Legislation)

rektiva 2009/28/EC e datës 23 Prill 2009 mbi nxitjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të ripërtëritshme

- Direktiva 2003/30/EC e datës 8 Maj 2003 mbi nxitjen e përdorimit të biokarburanteve ose karburanteve të tjera të ripërtëritshme në transport
- Direktiva 2001/77/EC e datës 21 Shtator 2001 mbi nxitjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme në tregun e brendshëm të energjisë elektrike.

I detyrueshëm i Republikës së Kosovës për gjenerim të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme deri në vitin 2020 të jetë 25 % e brutokonsumit përfundimtar<sup>10</sup>. Shprehur në Megavat dhe shpërndarë në vite, Republika e Kosovës duhet të diversifikoj burimet për gjenerim të energjisë elektrike dhe të ketë në dispozicion kapacitete të instaluara si në tabelën e mëposhtme.

Burimi i energjisë	Kapaciteti i Energjisë nga BRE-të i shpërndarë në vite dhe i shprehur në MW							
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energjia fotovoltaike	0	3	4	6	7	8	9	10
Biomasa solide	0	2	4	6	8	10	12	14
Era	1.35	31.35	70	90	110	130	140	150
Hidrocentralet e vogla ekzistuese	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21	46.21
Hidrocentralet e vogla të reja	0	60	140	150	160	180	200	240
Hidrocentrali i Zhurit	0	0	0	0	305	305	305	305
<b>Kapaciteti total në MW</b>	<b>47.56</b>	<b>142.56</b>	<b>264.21</b>	<b>298.21</b>	<b>636.21</b>	<b>679.21</b>	<b>712.21</b>	<b>765.21</b>

Direktivat e lartpërmendura si dhe të gjitha direktivat tjera të BE-së vlejné edhe për shtetet joanëtare të BE-së, ndër të cilat numërohet edhe vendi ynë.

Pra, secili shtet i cili është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është i obliguar që në afatin e caktuar ta bëjë përbushjen e të gjitha Aquis të BE-së e në këtë kontekst edhe Aquis mbi energjitë e ripërtëritshme dhe përbushjen e caqeve indikative.

Neni 4 i Vendimit Nr. D/2012/04/MC – EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, parasheh që caku

### **Energjitë e ripërtëritshme në Kosovë, Potencialet e Ujit**

Kosova për momentin nuk ka matje të sakta të potencialit të energjisë hidrike po mund të themi se Kosova nuk dallon shumë nga regjioni në këtë fushë. Pjesa përendimore e Kosovës disponon potencialin hidroenergjetik të Drinit të Bardhë dhe lumenjë të tjerë.

<sup>10</sup>Burimet e Ripërtëritshme, Raport global për gjendjen, 2013, [http://www.ren21.net/portals/0/documents/resources/gsr/2013/gsr2013\\_lowres.pdf](http://www.ren21.net/portals/0/documents/resources/gsr/2013/gsr2013_lowres.pdf)

Zhvillimi teknikuteknologjik për shfrytëzimin e energjisë hidrike i cili qdo ditë e më shumë po avancoon do ta mundësonte prodhimin e energjisë nga cdo pikë uji në lëvizje. Kjo për Kosovën do të jetë një përparësi e madhe.

Sipas matjeve aktuale, potenciali ekonomikisht i shfrytëzueshëm për prodhimin e energjisë hidrike paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

Nr	Lumi	Potenciali, ekonomikisht i shfrytëzueshëm
		MWh/vit
1	Drini i Bardhë	554,00
2	Ibri	102,17
3	Morava e Binçës	8,75
4	Lepenci	16,53
<b>Totali</b>		<b>681,45</b>

#### **Potenciali i diellit**

Rrezatimi diellor në Kosovë vlerësohet të jetë ndërmjet 1500 dhe 1650 kWh/m<sup>2</sup> në vit.

Me afërsisht 278 ditë me diell, Kosova mund të konsiderohet si një vend që ka predispozita të qarta për shfrytëzimin të këtij burimi. Poashtu, edhe intensiteti i rrezeve gjatë këtyre ditëve konsiderohet të jetë i ngjashëm me vendet të cilat vetëm kanë filluar të instalojnë panele solare. Bazuar në pozitën gjeografike dhe kushtet klimatike të Kosovës, energjia diellore mund të shfrytëzohet në masë të konsiderueshme për ngrohjen e ujit sanitar dhe për prodhim të energjisë fotovoltaike. Sipas të dhënave nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, vlerësohet të këtë mundësi të prodhimit të energjisë nga dielli afërsisht 1,100 kWh deri 1,250 kWh për m<sup>2</sup> në vit. Kurse sipas Ministrise se Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, rrezatimi diellor në vendin tonë vlerësohet të jetë ndërmjet 1500 dhe 1650 kWh/m<sup>2</sup> në vit.

Kjo poqëse kolektori diellor të jetë vendosur në pozitë ideale. Vonesat e aprovimit të tarifave nxitëse për energjinë elektrike nga dielli e kanë pamundësuar zhvillimin e prodhimit të kësaj energjie shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik.

#### **Potenciali i Erës**

Studimi „Energjia e ripërtëritshme si një shans i zhvillimit ekonomik në Kosovë“ i hartuar nga evroenergie L.L.C. me porosi të „Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ“ u publikua në Janar të vitit 2013 dhe tregon një potencial të madh të energjisë së erës në Kosovë duke u bazuar në matje të sakta dhe profesionale sipas kërkesave standarde për investitorë. Potenciali i përgjithshëm i energjisë së erës në Kosovë është përafërsisht 328 MW.

Nr.	Projekti	Kapaciteti në MW
1	Shtime 1	100
2	Shtime 2	27
3	Kitka,	30
4	Golesh(Windpower)	1.36
5	Nek Zatriq	30
6	Bajgore	50 (Matjet vazhdojnë)
7	Skenderaj	50 (Matjet vazhdojnë)
8	Budakova	40
	<b>Total</b>	<b>328.36</b>

Kosova dhe regjioni nuk posedojnë një atlas të erës përderisa një i tillë është duke u financuar nga Kreditanstalt für Wiederaufbau – KfW, I cili do të prezantohet në pjesën e dytë të këtij viti (2014).

#### **Potenciali i Biomassës**

Biomasa është një burim i energjise së ripërtëritshme dhe mund të konvertohet direkt në energji, gjatë djegies. Duke shfrytëzuar kështu biomasën përfitohet ngrohje dhe energji elektrike. Nga ana tjetër forma më e zhvilluar e konvertimit të biomasës është fermentimi në alkohol. Biogasi i fituar nga mënyra e këtillë e fermentimit, përmbanë metan dhe karbon dhe për këtë arsye mund të përdoret si lëndë djegëse. Avantazh i përdorimit të biomasës është edhe psh. riciklimi i mbeturinave dhe mbetjeve nga bujqësia, mbetjet pyjore, mbetjet nga industria e drurit te cilat cojnë në zvogëlimin e importeve të energjisë.



Më poshtë është paraqitur një tabelë si tregues i masës drusore e marur nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural<sup>11</sup>.

Statusi	Vëllimi (m3)			Vëllimi sipas përbërjes të pyjeve(m3/ha)			
	Shfrytëzue shëm	Joshfrytëz ueshëm	Total	Halorë	Përzier	Fletorë	Total
<b>Shtrirë</b>	226 000	399 000	625 000	10.9	0.96	0.79	1.30
<b>Këmbë</b>	556 000	555 000	1 111 000	20.3	5.55	1.3	2.31
<b>Totali</b>	782 000	954 000	1 736 000	31.2	6.51	2.09	3.61

Tabela 5: Vëllimi total i drurit të thatë dhe sasisë së drurit të thatë për hektar (ha, m3)

### Potenciali Gjeotermik

Energjia gjeotermike si energji që del nga toka dhe që nuk emeton gazra të cilët e ndotin ambientin, hyn në kategorinë e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Në Kosovë, energjia gjeotermike ka filluar të përdoret vetëm viteve të fundit dhe niveli i investimeve në këtë lloj energjie është shumë i ulët dhe i kufizuar kryesisht në investime private. Përkundër kostos së lartë fillestare që kërkon instalimi i sistemit gjeotermik, dobitë në një periudhë afatgjate e tëjkalojnë këtë kosto. Kthimi i investimeve në instalimin e sistemit gjeotermik llogaritet të jetë 4 deri në 5 vite, varësisht prej kapacitetit të instaluar. Sipas një studimi të bërë të *Coordination of Research policies with the Western Balkan Countries*<sup>12</sup>, zëvendësimi i energjisë elektrike me atë gjeotermike do të rezultonte me një zvogëlim të shpenzimeve të ngrohjes për katër herë. Nëse një zëvendësim i tillë do të bëhej në nivel vendi, atëherë një pjesë e konsiderueshme e energjisë elektrike e cila do të përdorej për ngrohje do të mund të kursehej.

Si përfundim, prodhimi i energjise nga burimet e energjive te ripërtrishme në mënyra të qëndrueshme është edhe një sfidë sociale që kërkon një evolucion të rregullave ndërkombetare dhe kombetare (si në pjesën

e filluar me Direktiven RED 2009/28/CE)<sup>13</sup>, një planifikim për sektorin urban dhe atë të transportit, si dhe një ndryshim të stileve individuale të jetesës dhe konsumimit etik.

### Baza ligjore për eficiencën e energjisë në nivel vendi

Kosova sa i përketë regullativës ligjore primar dhe sekondar qëndron mjaftë mirë në raport me regjionin. Ligjet janë të harmonizuara me direktivat e Bashkimit Evropjan.

Ligji 03/L-201 për Energjinë elektrike

Ligji 04/L-016 për Eficiencën e energjisë

Ligji 03/L-116 për Ngrohje qëndrore

Ligji 04/L-110 për Ndërtim

### Nga ana tjetër janë përmbushur edhe sugjerimet e komunitetit për energji në Vjenë:

Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018

Plani i Kosovës për Eficiencë të Energjisë 2010-2018

Strategjia e ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011-201

### Më pak CO2, më shumë burime të energjive të ripërtrishme, eficiencë më e madhe

### Roli i eficiencës në zhvillimin ekonomik të komunave

Eficienca e energjisë është bërë pjesë e pandashme e sektorit energjetik në aspektin e zhvillimit ekonomik. Zhvillimi ekonomik i një shteti do të thotë zhvillim ekonomik i komunave. Pra bara kryesore për eficiencën

<sup>11</sup> *Inventarizimi Nacional i Pyjeve Kosovë, Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, 2013*  
[http://www.mbpzhr-ks.net/documents/84090\\_Inventarizimi-Nacional-i-Pyjeve-Kosov%C3%AB-2012\\_web.pdf](http://www.mbpzhr-ks.net/documents/84090_Inventarizimi-Nacional-i-Pyjeve-Kosov%C3%AB-2012_web.pdf)

<sup>12</sup> *RAPORT NACIONAL MBI GJENDJEN E ENERGJISË NË KOSOVË, 2012*  
[http://wbc-in-co.net/object/document/9828/attach/0\\_National\\_Background\\_Report\\_Energy\\_Kosovo\\_2012.pdf](http://wbc-in-co.net/object/document/9828/attach/0_National_Background_Report_Energy_Kosovo_2012.pdf)

<sup>13</sup> *Direktiva Europiane për Burime të Ripërtrishme (RED), Direktiva 2009/28/EC në promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtrishme*  
<http://dglassassociates.wordpress.com/2013/01/22/european-union-renewable-energy-directive/>

e energjisë bie tek komunat. Duke qenë se eficienta konsiderohet për ditë e më shumë si faktor i zhvillimit ekonomik global, jemi dëshmitarë që institucionet e ndryshme dhe të mëdhaja financiare si dhe bankat lokale po investojnë më shumë në këtë fushë. Një vështrim mbi regjionin tregon qartë potencialin e madh në regjion sa i përketë eficiencës së energjisë. Sipas Bankës Botërore<sup>14</sup> intensiteti rajonal i energjisë është 2.5 herë më i lartë se në Bashkimin Evropian ndërsa potenciali i investimeve në eficiencë të energjisë është përafërsisht 2.5 miliard Euro. Potenciali më i madh këtu është paraqitur të jetë në ndërtesat publike me 35 deri 40 % mundësi të kursimit të enegjisë.

Sector	Energy Savings Potential (%)
Transport	10
Residential	10-35
Public	35-40
Service	10-30
Industry	5-25

Vetëm qeveritë e vendeve në regjion harxhojnë diqka më shumë se 400 milion Euro në energji për ndërtesat dhe objektet tjera, duke përfshirë edhe ndriqimin publik. Sa i përketë financimit të eficiencës së energjisë kemi vetëm nga Bashkimi Evropian një fond prej 1.5 Miliard Euro për projekte të cilat do të mund të shfrytëzoheshin nga vetë komunat. Këto shuma të mëdha të parave janë mundësi e mirë për komunat, të paraqiten me projekte për eficiencë të energjisë dhe të zhvillojnë brenda përbrenda komunës kompetenca në këtë fushë. Duke marrë parasyshë faktin që një komunë ka mundësi të kursej deri në 40% të energjisë në objektet publike mund të themi që po e njejta komunë këto mjete mund ti përdorë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të cilat do të ndikonin

rrjedhimisht në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e vet.

Komunat si pronare respektivisht si operuese të një sërë objekteve të ndryshme publike si Shkollat, Qendrat e Mjeksisë Familjare, Ndërtesat e Administratës Komunale, Ndrçimi Publik , Transporti Publik, etj. duhet që çështjen e eficiencës së energjisë ta shohin si një rol kyç të tyre në zhvillimin ekonomik.

Humbjet e energjisë te objektet e vjetra dhe ndërtimin e objekteve të reja joeficiente, qofshin ato publike apo private janë drejtepërdrejtë humbje të buxhetit komunal, gjegjësisht të buxheteve familjare. Me direktivën evropiane<sup>15</sup> obligohen shtetet të themelojnë agjensitë e eficiencës të cilat do ti jepte përkrahje komunave në përpilimin e planeve të veprimit për eficiencën e energjisë.

Për të patur sukses kjo agjenci, do të duhej të themelohej fondi për eficiencë, i cili do të formohej nga buxheti i Kosovës, nga institucionet financiare ndërkombëtare, nga taksat që do të grumbulloheshin nga bizneset që merren me eficiencë (licencimi, certifikimi etj) si dhe nga ndëshkimet për moszbatimin e masave të eficiencës. Në rastin e Kosovës për shkak të implikimeve buxhetore, themelimi i një fondi të këtillë bjen ndesh me Kushtetutën e vendit. Për këtë arsye është nevojë urgjente që nga organet përkatëse kushtetuese të gjindet zgjidhja sa më shpejtë për këtë problem.

Nga paslufta e deri më sot në Kosovë ka pasur auditime, propozime dhe implementim të masave për eficiencë në objektet publike me financim nga institucione të ndryshme ndërkombëtare. Roli i komunave në këto investime nuk ka qenë i paraparë fare. Kjo padyshim që ka dëmtu në të shumtën e rasteve komunat për shkak të kualitetit të dobët të zbatimit të masave eficiente në objektet përkatëse si dhe në punësimin e stafit lokal.

<sup>14</sup> Energjia Efiçiente dhe Burimet e Ripërtrishme në Ballkanin Perendimor, Jas Singh, 2013.

<sup>15</sup>EU Energy Efficiency Directive (2012/27/EU), Guide-book for Strong Implementation, [http://eedguidebook.energycoalition.eu/images/PDF/EE\\_D.pdf](http://eedguidebook.energycoalition.eu/images/PDF/EE_D.pdf)

### **Pse eficienca e energjisë ndikon në zhvillimin ekonomik të komunave?**

Vet zbatimi dhe implementimi i masave të eficiencës së energjisë në objektet publike dhe private prodhon efekte zingjir. Ato janë:

- Punësimi eventual në prodhimin e produkteve për eficiencë
- Punësimin në montimin e produkteve të eficiencës
- Rritja e kapaciteteve humane në fushën e eficiencës
- Punësimi në administratën komunale

### **ESCO Kompani**

ESCO (Energy Service Company) është një kompani që ofron shërbime të energjisë të cilat përfshijnë zbatimin e projekteve të eficiencës së energjise ( gjithashtu edhe projekte për energji të ripërtëritshme). Këto kompani zhvillojnë, instalojnë dhe rregullojnë financimin e projekteve të cilat janë të dizajnuara të ngrisin eficiencën e energjisë.

Shërbimet e energjisë përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh, të tilla si:

- Analiza dhe auditime të energjisë,
- Menaxhimin i energjisë,
- hartimin dhe zbatimin e projektit,
- mirëmbajtjen dhe operimin,
- Monitorimin / dhe vlerësimin e kursimeve,
- Menaxhimin e pronës / objektit,
- Ofrimin i shërbimeve (ngrohje, ndriçim, etj)

### **Përgjegjësitë për eficiencën e energjise sipas hierarkisë në Kosovë**

#### **Ministria së Zhvillimit Ekonomik**

- Përgatitja dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit për sektorin e energjisë dhe minierave, sektorin postar, sektorin e telekomunikacionit, sektorin e teknologjisë informative, si dhe sektorin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve publike,
- Përgatitja dhe implementimi i dokumenteve dhe strategjive për sektorin e energjisë dhe

Minierave, si dhe dokumenteve të balancave të energjisë, sipas legjislacionit në fuqi,

- Përgatitja e politikave të Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, si dhe e planeve të veprimit për këto dy fusha, në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- Monitoron sistemet e energjisë,
- Bashkëpunon në përgatitjen dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorin e energjisë, sektorin e minierave, sektorin postar, sektorin e telekomunikacionit dhe sektorin e teknologjisë informative,
- Bashkëpunon me Ministrinë e Financave në funksion të zhvillimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e investimeve në sektorët e përgjegjësive të veta nëpërmjet politikave fiskale, tatimore etj.

#### **Agjencia Kosovare për Eficiencën e Energjisë**

- i propozon ministrit politikat për promovimin e eficiencës së energjisë,
- zhvillon dhe mirëmbanë bazën e të dhënave për eficiencën e energjisë,
- zhvillonë sistemin e monitorimit të implementimit të Planit të Kosovës për eficiencën e energjisë dhe përmbushjes të caqeve indikative për kursim të energjisë,
- i propozon ministrit Planin e Kosovës për eficiencën e energjisë,
- përgatitë Raportin e progresit të Zbatimit të Planit të Kosovës për eficiencën e energjisë,
- i udhëzon dhe i mbështetë komunat për përgatitjen e planeve komunale për eficiencën e energjisë dhe raporteve të tyre të progresit,
- promovon eficiencën e energjisë nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese,
- paraqet rekomandime për përmirësimet e nevojshme në planet e eficiencës së energjisë, të nivelit qendrorë dhe komunal,
- bashkëpunon me ministrinë dhe institucionet e tjera relevante në implementimin e planeve të eficiencës së energjisë,
- mbështetë pjesëmarrjen e palëve te interesuara në ndërmarrjen e iniciativave për eficiencën e energjisë,
- i propozon ministrisë përmirësimin dhe plotësimin e bazës ligjore dhe rregullative në fushën e eficiencës së energjisë, me qëllim të

harmonizimit të tyre me standardet relevante evropiane për eficiencën e energjisë,

- mbështetë zyrat komunale të energjisë për çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe promovimin e eficiencës së energjisë dhe implementimin e programeve të ndryshme të eficiencës së energjisë në nivel komunal,
- promovon aktivitetet informative dhe edukative në fushën e eficiencës së energjisë, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për energjinë, ndërtimin dhe arsimin.
- përgatit raportin vjetor të punës për ministrin,

### Zyrat Komunale për Eficiencën e Energjisë

- Zhvillimi lokal ekonomik,
- Planifikimi urban dhe rural,
- Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe i standardeve për kontrollimin e ndërtimit,
- Mbrojtja e mjedisit lokal,
- Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike,
- Planifikimi dhe zbatimi i masave për renovimin e objekteve publike dhe private të shërbimeve dhe të banimit,
- Shfrytëzimi eficient i energjisë,
- Përmirësimi i eficiencës së energjisë në transport publik,
- Promovimi i përmirësimit të eficiencës së energjisë nëpër ndërmarrje industriale dhe bujqësore,
- Zhvillimi i sistemeve eficiente energjetike,
- Zbatimi i fushatave të vetëdijësimit,

### Rekomandimet

Në bazë të gjithë kësaj që u tha më lartë vijmë në përfundim se njëra nga shtyllat kryesore e buxhetit të komunës do të mund të ishin energjitë e ripërtritshme dhe eficienta e energjisë. Në rastin e Kosovës për fat të keq nuk ka as një cent të hyra në buxhetet komunale dhe të punësuar në komuna nga energjitë e ripërtritshme dhe eficienta e energjisë.

Unë rekomandoj:

- që me urgjencë të fillohet me përpilimin e koncepteve komunale që do të kishin ndikim të madh në vet komunat,
- fillimin e përpilimit të strategjisë së mirëfilltë të energjisë, duke u bazuar në rezultatet e koncepteve komunale dhe duke hequr dorë nga strategjitë formale, që ndikojnë negativisht në zhvillimin e sektorit të energjisë,
- krijimin e bazës ligjore dhe kushtetuese për themelimin e fondit për zhvillim të energjive të ripërtritshme dhe eficientë, në këtë rast, ky fond do të përbëhej nga buxheti shtëror dhe do të krijoheshin mundësitë edhe të tërheqjes së fondeve të ndryshme,
- financimin e një projekti, që do ta krijonte një databazë të objekteve të renovuara nga fondet për eficientë, e cila do të shërbente për auditim duke mundësuar krahasimin e këtyre investimeve për nga cilësia e punëve të kryera.

Krahasimi do të bëhej:

- në objektet brenda një komune
- në komunat në mes vete në Kosovë si dhe
- me një komunë në regjion (Maqedoni)

Një krahasim i tillë do të shërbente si udhërrëfyes që të mos kemi dështime të tjera në investime.

**Rreth autorit:**

**Hamdi Malushaj** është inxhinier i makinerisë - termoenergjetikë. Ka punuar 18 vite në këtë sektor dhe pastaj ka vendosur të vazhdojë punën në këtë drejtim duke u specifikuar në sektorin e energjisë. Iu bashkua këtij sektori duke u bërë drejtor menaxhues i evroenergie L.L.C. ku është përgjegjës për strategjinë e korporatës, rritjen e fitimit dhe operimin e kompanisë.

Një objektiv i mëtejshëm i z. Malushaj është kryerja e analizave përkatëse në fushën e ekonomisë energjetike në tregun e Evropës Juglindore. Ai ka punuar si menaxher i projektit në projekte të ndryshme. Veqohen tri analiza: " Burimet e ripërtrishme Energjisë në shërbim të Zhvillimit Ekonomik në Kosovë", "Proceset e reja për krijimin e vlerës së shtuar në sektorin e metalit për përmirësim të teknologjive të energjisë (BRE & EE) dhe "Zhvillimi i rekomandimeve të praktikave më të mira për ndërrimin e furnitorit në Komunitetin e Energjisë". Ai është poashtu kryetar i Shoqatës për Energji të Ripërtrishme të Kosovës.

**Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.**

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung  
Zyra në Kosovë  
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6  
KO-10000/Pristina  
Telefon +381 (0) 38 229 874  
[Prishtina@kas.de](mailto:Prishtina@kas.de)  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)